



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 71

Prishtinë, më 12 shkurt 2014, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P r o c e s v e r b a l

I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Hamza Balje.

Munguan: Berat Buzhala dhe Sabri Hamiti.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK, Kaltrina Shala-programi IPS dhe mediat.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 janar 2014;
3. Shqyrtim i Rezolutës së Parlamentit Evropian, për procesin e integritetit evropian të Kosovës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24 janar 2014;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi njëzëri procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 24 janar 2014.

3. Shqyrtim i Rezolutës së Parlamentit Evropian, për procesin e integritimit evropian të Kosovës

Albin Kurti fillimisht tha se në këtë Rezolutë të PE-së për procesin e integritimit evropian të Kosovës, të dt. 16 janar 2014, për dallim nga ajo e vitit të kaluar, Kosova është paraqitur pa fusnotë. Rezoluta përmban 53 pika, dhe prek shumë sfera të rëndësishme të jetës shoqërore, ekonomike e politike në Kosovë. Ai, njoftoi se javën e ardhshme do të jetë në Bruksel dhe diskutimin e bërë në Komision lidhur me Rezolutën, do të mund ta përcillte te zyrtarët e Komisionit Evropian, por edhe te deputetët e Parlamentit Evropian.

Skender Hyseni theksoi se Rezoluta në fjalë në lexim të parë lë përshtypjen se fusnota nuk figuron, por në faqen e dytë të Rezolutës fusnota citohet, madje gabimisht, për të cilin gabim tha se ne duhet të tërheqim vërejtjen. Ky lëshim tha z. Hyseni, sigurisht se është bërë pa dashje, ku përmendet mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, për pajtueshmëri të njëanshme, që është gabim dhe konsideron se është marrë formulimi që ja ka bërë qeveria serbe lëndës, para se ta dorëzonte në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Është mirënjohës për qëndrimin e PE- së ndaj Kosovës, për të cilin thotë se është disa hapa para qëndrimit të Komisionit Evropian, gjë që pasqyrohet edhe në pikën 3 ku thuhet se mandati i negociatave për MSA, dallon nga ai për marrëveshjet paraprake të stabilizim-asociimit.

Emilija Rexhepi me këtë Rezolutë të Parlamentit Evropian, për procesin e integritimit evropian të Kosovës, tha se kemi mundësinë t'i shohim të arriturat si shtet dhe çka na ka mbetur për të plotësuar drejt procesit të stabilizimit. Mbështetur në pikat e Rezolutës theksoi në mes tjerash, se është obligim i Qeverisë dhe i të gjithë neve që të implementohen ligjet në praktikë, të kemi siguri në veri të Kosovës, të angazhohemi kundër krimit, korrupsionit, të shtojmë numrin e femrave në administratën publike dhe të përmbushim disa pika të tjera të cilat na e dëmtojnë imazhin e vendit tonë. Theksoi se kjo Rezolutë paraqet një pasqyrë reale të situatës në Kosovë, ashtu siç është.

Hydajet Hyseni theksoi se kjo Rezolutë paraqet një pasqyrë reale të gjendjes në të cilën gjendemi, ka lëvizje përpara, por ka edhe sfida për të cilat duhet të angazhohemi që të tejkalohen. Vuri në pah se PE ka një qëndrim më të avancuar, por edhe më parë ka pasur një qëndrim më të avancuar rreth obstrukcioneve që na janë imponuar. Pajtohet me parafolësit se është keq që fusnota është e shpërndarë në tekst të Rezolutës, por kjo tha se mbetet një sfidë e Kosovës në të ardhmen.

Në Këshillin e Evropës tha se përdoret njëfarë fusnote edhe më e pasaktë, në të cilën referenca është vetëm në Rezolutën 1244, përmendet emri Kosovë dhe gjithë territori i saj, ndryshe nga fusnota injorohet opinionin e GJND- së. Këtë çështje e kemi shtruar në forma të ndryshme dhe ka pasur mirëkuptim, por jo edhe lëvizje konkrete. Ekziston klauzola ku thuhet se dy palët nuk duhet të pengojnë njëra- tjetrën në procesin e integritimit të bashkëpunimit rajonal e më gjerë, por në fakt pala serbe përpiqet ta legalizojë në njëfarë mënyre qëndrimin e saj mos njohës dhe bllokues ndaj realitetit të ri në Kosovë.

Në këtë drejtim tha se nuk duhet të jemi vetëm vëzhgues dhe konstatues të zhvillimeve eventuale por duhet të përpiqemi që të jemi pjesë aktive në ndërtimin e këtyre qëndrimeve.

Donika Kadaj-Bujupi tha se Rezoluta e PE- së për procesin e integritimit evropian të Kosovës, paraqet pak a shumë një pasqyrë reale të situatës tonë. Në çështjet që kanë të bëjnë më tepër me situatën politike dhe me të drejtat e njeriut tha se mund të japim sqarime shtesë përmes një shkrese, se ka të arritura në këto fusha. Në këtë Rezolutë ka edhe pika të cilat janë pasqyruar me një gjuhë

shumë të kujdesshme siç janë: pika 1 e cila lidhet me mungesën e një plani të veprimit ose qasjes së Kosovës në fondet e IPA; pika 39, ku flitet për varfërinë e lartë dhe kujdesin e pamjaftueshëm ndaj fëmijëve pleqve dhe mungesën e shërbimeve shëndetësore; pika 43 që flet për privatizimin, krijimin e infrastrukturës hekurudhore, kërkesa e vazhdueshme për mbylljen e Termocentralit A, si dhe pika 30 që kërkon nga Serbia që t'i kthejë trupat e gjetur në varrezën masive. Theksoi se për pikën 30 duhet të kërkohet që të sigurohet një mbështetje e plotë për kthimin në atdhe të trupave të kosovarëve të zhdukur që u gjetën në Serbi. Sa i përket propozimit në pikën 7 që autoritetet kosovare sa më parë në bashkëpunim me Komisionin e Venecias të nxjerrin Ligjin e ri zgjedhor tha se tani situata ka ndryshuar dhe Komisioni i Venecias nuk ka rol, as nuk ka pasur në këtë çështje sepse dështimi në reformë zgjedhore nuk lidhet me mos angazhimin e Komisionit, por lidhet me mungesën e vullnetit politik.

Enis Kervan tha se në Rezolutë flitet për sukseset e arritura, por ne kemi edhe shumë të arritura që nuk ceken në të, por edhe probleme të grumbulluara në Qeverinë e Kosovës, të cilat mund të ceken në këtë Rezolutë. Thirrja që i bëhet në Rezolutë, 5 shteteve të BE- së për njohjen e Kosovës, tha se nuk mjafton, PE duhet të punojë më shumë në këtë drejtim. Shumë herë flitet për shumë etnicitetet, dhe favorizohet vetëm komuniteti serb, ndërsa vetëm në pikën 21 flitet me një fjali për komunitetin turk, goran, boshnjak, etj. Favorizohet kisha ortodokse serbe, trashëgimia kulturore, përderisa në Kosovë trashëgimia kulturore nuk do të thotë vetëm kisha ortodokse serbe, shtoi z. Kervan. Ai tha se Rezoluta e favorizon komunitetin serb, ndërsa nuk i jep rëndësi komuniteteve jo serbe dhe ka diskriminim pozitiv për komunitetin serb. Propozoi që pika 44 e Rezolutës, ku i bënë thirrje Kosovës për bashkëpunim me odën ekonomike të Serbisë, të diskutohet sepse nuk ka arsye të qëndroj kjo pikë, në këtë mënyrë direkte.

Hamza Balje lidhur me Rezolutën, tha se ajo është mjaft koncize dhe është bazë për avancimin e procesit të integritetit evropian të Kosovës. Theksoi se pajtohet me diskutimin e z Kervan, lidhur me komunitet pakicë. Theksoi se edhe pse komuniteti boshnjak, turk e goran, nuk paraqesin probleme, nuk do të thotë se nuk duhet të kenë vend në këtë Rezolutë.

Komuniteti boshnjak, turk e goran, janë shembull për integritet në shoqëri dhe punë institucionale. Megjithatë kjo nuk do të thotë se komunitetet e tjera nuk kanë probleme dhe vështirësi, një ndër ato përmendi mungesën e teksteve shkollore të mësimin në gjuhën boshnjake. Shkollimi tha se është një çështje kruciale dhe bazë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Albin Kurti në diskutimin e tij lidhur me Rezolutën në mes tjerash tha se, ajo që ne mund ta bëjmë, është të jemi më të zëshëm, ndërsa i takon Qeverisë që të angazhohet më tepër. Ai tha se lëngimi në këtë aspekt është sepse takimet që i bëjnë përfaqësuesit e institucioneve tona me faktorët ndërkombëtarë janë më tepër ceremoniale se sa përmbajtjesore dhe se Komisioni ynë në këtë drejtim është dukshëm mbi këtë mesatare. Lidhur me formulimet në Rezolutë tha se pajtohet me anëtarët e Komisionit se ka disa formulime problematike që janë shprehje e riprodhimit të premisave. Vuri në pah se në pikën D të Rezolutës nuk thuhet ekonomia e tregut të lirë, por ekonomia e tregut shoqëror; pastaj në pikën 3 thuhet se për shkak të ndarjeve në Këshill mandati i negociatave dallohet nga ai për marrëveshjet paraprake të stabilizim-asociimit; konstatimi në pikën 6 nuk arsyetohet me bazën e raporteve, shënimeve apo fakteve; ndërsa për kërkesën për rivendosje të ligjit në veri të Kosovës, z Kurti tha se atje nuk kemi pasur vendosje të ligjit kurrë, që tani kërkohet rivendosja. Po ashtu tha se pika 15, lidhur me EULEX-in, duhet të ngritët sepse ai prej se është vendosur asnjëherë nuk i ka dhënë llogari Kuvendit. Ceku se përderisa në pikën 16 thuhet se 250 raste janë nën hetime nga EULEX-i, në pikën 27 shprehet keqardhje se krimi i organizuar, korrupsioni nuk janë prekur prej EULEX-it, dhe se a do të thotë kjo se angazhimi i EULEX-it për

250 raste është i përqendruar në krimet e luftës. Po ashtu theksoi se mund të ngritët për diskutim pika 38 e 39 e Rezolutës, si dhe diskriminimi i pakicave të komuniteteve të tjera. Ai theksoi se ka edhe çështje të cilat përsëriten që lënë përshtypjen e të qenit formal në përpilimin e kësaj rezolute substanciale. Propozoi që për çështjet të cilat u diskutuan nga anëtarët e Komisionit të përpilohet një shkresë dhe t'i drejtohet Parlamentit Evropian, Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian dhe grupeve parlamentare të PE-së.

Skender Hyseni propozoi që shkresa e cila do të formulohet për Parlamentin Evropian t'i përcillet edhe Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, ngase atyre ju takon t'i përditësojnë të arriturat në çdo fushë, në mënyrë që edhe në BE ta ndërrojnë gjuhën e tyre.

Pas diskutimit të anëtarëve të Komisionit lidhur me Rezolutën e Parlamentit Evropian, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni përmes një shkrese t'i adresojë komentet e tija lidhur me Rezolutën e Parlamentit Evropian për procesin e integrimit evropian të Kosovës, të dt. 16 janar 2014, në Parlamentin Evropian, në Komisionin për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian dhe te grupet parlamentare të PE-së.

Shkresa e cila do t'i adresohet PE-së, t'i përcillet edhe Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës.

Çështjet e ngritura në Komision, anëtarët e Komisionit mund t'i ngritin edhe në takimet e tyre me strukturat e PE-së.

4. Të ndryshme

Lidhur me kërkesën për vizitë të delegacionit të Komisionit në Parlamentin Evropian, Komisioni vendosi që të kërkohet që vizita të organizohet gjatë muajit mars apo prill, në përbërje prej pesë anëtarësh, në kohëzgjatje prej dy ditësh.

Takimi përfundoi në orën 11:05.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit